



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

**Ligji Nr.2004/30**

**PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA**

Kuvendi i Kosovës,

Në mbështetje të Rregullores nr.2001/9 të dt.25 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë, veçanërisht Krerët 5.1 (f), 5.7, 9.1.26 (a), 9.3.3, 11.2 dhe tutje;

Duke parë nevojën për të sjellë standarde për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja në Kosovë në harmoni me ato të Bashkimit Europian;

Të dedikuar pas qëllimit për të mundësuar një mjedis të shëndetshëm për popullin e Kosovës;

Duke patur parasysh së vënja e standardeve të tilla dhe krijimi i një mjedisi të tillë duhet të formohet në mënyrë që të jetë konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe që Kosova të mund të përballojë si të tilla; dhe

Me qëllim krijimin e bazës së kornizës ligjore që do të:

- I. mundësojë një mjedis më të shëndetshëm gjatë sjelljes graduale të standardeve të Bashkësisë Europiane për mjedis,
- II. sigurojë që për krijimin e një mjedisi të shëndosh që përballon ndotjet dhe shpenzimet për mbrojtje të ajrit nga ndotja dhe është konform me zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik,
- III. krijojë kompetencat dhe detyrimet e autoriteteve publike që janë përgjegjëse për sjelljen dhe fuqizimin gradual të standardeve të tilla, dhe
- IV. japë të drejtat dhe detyrimet e personave dhe ndërrmarjeve që preken nga aktivitete të tilla ose intereset që promovojnë një mjedis të shëndetshëm në Kosovë;

Miraton:

# LIGJIN PËR MBROJTJEN E AJRIT NGA NDOTJA

## KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Qëllimi

#### Neni 1

Ky ligj ka për qëllim të rregulloj dhe garantoj të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.

### Përkufizime

#### Neni 2

Në kuptim të këtij ligji:

“**Ajër i mjedisit**” është ajri i jashtëm në troposferë, duke mospërfshirë atë në vendet e punës.

“**Ndotës**” janë substancat që futen në mënyrë të drejtpërdrejt apo tërthorazi në ajër, të cilat shkaktojnë efekte të dëmshme në shëndetin e njeriut, florën, faunën dhe trashëgiminë kulturore.

“**Treguesi mjedisor**” është treguesi që jep të dhëna për një dukuri mjedisore, duke e bërë atë të përceptueshme nëpërmjet vlerës numerike, matjes dhe komunikimit, prej nga:

- i. “**Treguesi mjedisor i gjendjes së ajrit**” është treguesi që jep të dhëna për cilësinë e ajrit;
- ii. “**Treguesi mjedisor i trysnisë në ajër**” është treguesi që jep të dhëna për trysnitë që ushtrojnë në ajër burimet e ndotjes.

“**Smog**” është përzierje e mjegullës , tymit dhe pluhurit që krijohet në rajonet industriale dhe urbane me pasoja të mëdha për shëndetin e popullatës.

“**Monitorimi**” është procesi që realizon vlerësimin sistematik të treguesve mjedisorë.

“**Burim ekzistues i ndotjes**” është veprimtaria që ka filluar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

“**Burim i ri ndotjeje**” është veprimtaria që fillon pas hyrjes në fuqi të këtij ligji.

“**Norma e cilësisë së ajrit**” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit dhe që shprehet me masë të një ndotësi në njësinë e vëllimit të ajrit.

“**Norma e depozitimit**” është vlera më e madhe e lejueshme e një treguesi mjedisor të gjendjes së ajrit dhe që ushtron ndikim në mjedis dhe që shprehet në masë të tij në njësinë e sipërfaqes për kohë të caktuar.

“**Norma e shkarkimeve në ajër**” është sasia më e madhe e lejuar e ndotësit, që shkarkohet në ajër nga një burim ndotjeje, i cili nuk tejkalon nivelin e lejuar të treguesve mjedisorë të trysnisë. Ajo shprehet si përqendrim në masë për vëllim, masë për kohë dhe masë për njësi të prodhimit, ose masë për njësi të energjisë.

“**PM10** “ nënkupton grimca 50% e të cilave kalojnë nëpër selektorë me diameter aerodinamik prej 10 mikrometra .

“**PM2.5**, nënkupton grimca 50% e të cilave kalojnë nëpër selektorë me diameter aerodinamik prej 2.5 mikrometra.

“**Burim i lëvizshëm**” quhet objekti që shkarkon ndotës, gjatë lëvizjes.

“**Operatori i burimit të ndotjes**” është çdo person fizik ose juridik, pronar i një burimi ndotjeje.

“**Autoriteti i mbrojtjes së ajrit**” është Ministria e Mjedisit dhe organet e tjera të autorizuara me aktenënligjore të nxjerrura nga Ministria.

“**Emision**” do të thote lirimi (shkarkimi) i substancave prej çfarëdo burimi në ajrin mjedisor.

## Burimet e ndotjes dhe klasifikimi i tyre

### Neni 3

#### 3.1. Burimet e ndotjes së ajrit janë:

- a. burimet e palëvizshme, të cilat përfshijnë impiantet teknologjike që kanë pajisje të palëvizshme për djegien e lëndëve të ndezshëm, pajisjet për procese teknologjike, mihjet sipërfaqësore, zona me vetëdezeje, veprimtaritë ku puna që kryhet mund të shkaktojë ndotje të ajrit, magazinimet e lëndëve të djegshme, për lëndë të para, për produkte dhe mbetje;
- b. burime të lëvizshme të ndotjes.
- c. burime të vogla ndotjeje cilësohen edhe pajisjet për procese teknologjike, që nuk përfshihen në burimet tjera të ndotjes, veprimtaritë që shkaktojnë ndotjen e ajrit, magazinimet e karburanteve, të lëndëve të djegshme, të lëndëve të para, të mbetjeve dhe ndotësve të grumbulluar.
- d. burimet difuzive të cilat përfshijnë paisjet, sipërfaqet dhe hapësirat tjera nga të cilat materiet ndotëse përhapen lirshëm, në ajër pa pasur tymtar apo mjete tjera të shkarkimit.

#### 3.2. Qeveria me propozimin e MMPH miraton burime të tjera të ndotjes, që mund të shfaqen si ndotës të ajrit.

## KREU II TREGUESIT E CILËSISË SË AJRIT

### Treguesit bazë

#### Neni 4

4.1. Treguesit mjedisor bazë të cilësisë së ajrit shprehin përqendrimin në ajër të lëndëve të gazta, të ngurta e të lëngëta, si më poshtë:

- a. të lëndës së ngurtë, të grimcave (aerosole, mjegull, tym, pluhur, blozë);
- b. të dioksidit të sulfurit;
- c. të monoksidi i karbonit;
- d. të ozonit;
- e. të plumbit, merkuri, arseni, kadmiumi, nikeli dhe komponimet e tyre.;
- f. të oksideve të azotit;
- g të halogjeneve;
- h. të hidrokarbureve (benzeni);
- i. rrezatimi jonizues dhe jojonizues;
- j. PM10, PM2.5, PM1.

4.2. Me akt të veçantë përcaktohen treguesit tjerë mjedisor të cilësisë së ajrit.

4.3. Për zona të veçanta dhe në varësi të natyrës së shkarkimeve në ajër, Qeveria me propozimin e MMPH, miraton treguesit tjerë mjedisor të cilësisë së ajrit.

### Miratimi i normave

#### Neni 5

Normat e cilësisë së ajrit, të depozitimit dhe normat specifike për zona të veçanta, miratohen nga Qeveria, me propozim të MMPH dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

## KREU III KUFIZIMI I SHKARKIMEVE NË AJËR

### Kufizimet

#### Neni 6

6.1. Kufizimi i shkarkimeve në ajër realizohet nëpërmjet vendosjes dhe zbatimit të detyrueshëm të normave të shkarkimeve.

6.2. Qeveria, me propozimin e MMPH, miraton normat e shkarkimeve në ajër, bazuar në normat e Bashkimit Europian dhe të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

## Normat e përkohshme

### Neni 7

7.1. Për burimet ekzistuese të ndotjes së ajrit, që funksionojnë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, kur niveli i teknikës dhe teknologjisë nuk lejon të zbatohen normat e shkarkimeve sipas këtij ligji, MMPH autorizon vendosjen e normave të përkohëshme. Normat e përkohshme dhe mënyrat për vendosjen e tyre miratohen nga Qeveria me propozimin e MMPH.

7.2. Kur edhe pas zbatimit të normave të përkohshme të shkarkimeve, burimi i ndotjes dëmton shëndetin e njeriut dhe mjedisin, MMPH urdhëron mbylljen e tij.

## Lartësitë e pajisjeve shkarkuese

### Neni 8

Pajisjet shkarkuese të burimeve të ndotjes duhet të kenë lartësi të tillë, që vlera e treguesit mjedisor të gjendjes së ajrit të mos kalojë limitin e lejuar të cilësisë për një ndotës të dhënë. Lartësia e pajisjeve shkarkuese caktohet, rast pas rasti, në lejen mjedisore.

## Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme

### Neni 9

9.1. Për burimet e lëvizshme, normat e shkarkimeve përcaktohen mbi bazën e treguesve mjedisorë të trysisë në gazrat e shkarkuara nga këto burime, të cilat janë: përqendrimi i blozës, oksideve të karbonit, e oksideve të azotit, e hidrokarbureve, e plumbit dhe e sulfurit.

9.2. Normat e shkarkimeve nga burimet e lëvizshme miratohen nga Qeveria me udhëzim të përbashkët të MMPH, Ministrisë për Shëndetësi dhe të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit.

## KREU IV DETYRIMET PËR MBROJTJEN E AJRIT

### Detyrime të përgjithshme

#### Neni 10

10.1. Personat fizikë e juridikë, vendas ose të huaj, kanë detyrë të ruajnë pastërtinë e ajrit, t'a mbrojnë atë nga ndotjet e shkaktuara nga veprimtaria që ushtrojnë në territorin e Kosovës dhe detyrohen të:

- a. monitorojnë emisionet,
- b. minimizojnë emisionin e ndotësve dhe erërave të pakëndëshme,
- c. mos tejkalojnë vlerat limituese të emisionit.

10.2. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit, tregtarët dhe përdoruesit e pajisjeve, prodhimeve, materialeve dhe substancave që ndotin ajrin, janë të detyruar të marrin masa që garantojnë mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

10.3. Prodhuesit dhe importuesit e burimeve të lëvizshme, prodhojnë dhe importojnë vetëm ato mjete e pajisje që plotësojnë normat e shkarkimeve.

10.4. Burimet e lëvizshme me motorë me djegie të brendshme i nënshtrohen kontrollit të shkarkimeve të gazeve ndotës, sipas rregullave që përcakton Ministria e transportit dhe telekomunikacionit.

10.5. Prodhuesit, importuesit, eksportuesit, transportuesit dhe tregtuesit e lëndëve djegëse detyrohen t'i prodhojnë, t'i importojnë dhe t'i tregtojnë ato në përputhje me kërkesat e cilësisë, të miratuara nga Qeveria, me propozimin e MMPH.

10.6. Ndalohet djegia e lëndëve të tjera, të ndryshme nga:

- a. Ato të përcaktuara nga prodhuesi i pajisjes dhe nga ato të përcaktuara në lejen e përdorimit të objektit, të prodhimit e të tregtimit të lëndëve djegëse;
- b. Lëndët djegëse të përcaktuara në parametrat teknikë ose në masat tekniko-organizative për vënien në përdorim të burimeve të ndotjes.

10.7. Ndërtimi i impianteve të reja dhe rinovimi i impianteve ekzistuese lejohet vetëm me teknologjitë ekologjike.

#### Detyrimet kryesore të operatorëve të burimeve të palëvizshme të ndotjes

##### Neni 11

11.1. Operatorët e burimeve të ndotjes detyrohen:

- a. t'i përdorin këto burime vetëm sipas kushteve teknike dhe kushteve të vëna në lejen mjedisore;
- b. të përgatisin rregullore teknike për funksionimin e burimeve të ndotjes, të cilat kontrollohen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit;
- c. të kryejnë monitorimin e shkarkimeve në ajër dhe të publikojnë periodikisht të dhënat e tij, si dhe masat e marra për kufizimin e ndotjes;

11.2. Operatorët e burimeve ndotjese sigurojnë veprimtarinë normale dhe përgatisin listën e parametrave teknikë, operacionalë dhe masat tekniko-organizative, për burimet e ndotjes, të cilat kontrollohen nga Inspektorati i Mbrojtjes së Mjedisit.

## Detyrimet kryesore të operatorëve të burimeve të lëvizshme të ndotjes

### Neni 12

Operatorët e burimeve të lëvizshme të ndotjes detyrohen t'i përdorin dhe t'i mirëmbajnë ato në përputhje me kushtet e përcaktuara nga prodhuesit e tyre, në pajtim me normat e shkarkimeve, të respektojnë masat që udhëzon MMPH dhe pushteti lokal për zonat që kërkojnë mbrojtje të veçantë të cilësisë së ajrit.

## KREU V ZONAT ME MBROJTJE TË VEÇANTË

### Shpallja dhe mbrojtja e tyre

#### Neni 13

13.1. Territoret e kufizuara dhe me ndotje të madhe të ajrit, me propozimin e MMPH dhe Ministrisë së Shëndetësisë, shpallen nga Qeveria si zona që kërkojnë mbrojtje të veçantë të ajrit nga ndotja.

13.2. Për zonat me mbrojtje të veçantë, MMPH, Ministria e Shëndetësisë dhe pushteti lokal përkatës udhëzojnë masa të veçanta për mbrojtjen e cilësisë së ajrit.

13.3. Në zonat me mbrojtje të veçantë, për qëllimet e sistemit rregullues të paralajmërimit të smogut, ngriten sisteme paralajmëruese e sinjalizuese të smogut, si dhe hartohen masat emergjente, që do të merren nga organet shtetërore dhe operatorët për të normalizuar gjendjen.

13.4. Kriteret e ngritjes dhe të vënies në funksionim të sistemit paralajmërues për smogun, miratohen nga Qeveria, me propozimin e MMPH.

### Gjendja e smogut

#### Neni 14

14.1. Për të parashikuar dhe paralajmëruar smogun, ngriten sistemet e posaçme paralajmëruese dhe rregullatore për smogun.

14.2. Ministria e Mjedisit, në bashkëpunim me institute të specializuara, harton kriteret e ngritjes dhe të funksionimit të këtyre sistemeve, të cilat miratohen nga Qeveria.

### Masat për përballimin e smogut

#### Neni 15

15.1. Kur parashikohet gjendje smogu, MMPH shpall masa paralajmëruese, njofton Qeverinë, pushtetin lokal përkatës dhe publikun.

15.2. Në një gjendje smogu, MMPH shpall masa rregullimi, për të ndaluar dhe kufizuar shkarkimet nga burimet e ndotjës së ajrit.

15.3. Për zvogëlimin dhe shmangien e smogut, operatorët zbatojnë masat e paralajmërimit e të rregullimit, si dhe njoftojnë periodikisht publikun, pushtetin lokal dhe MMPH.

**KREU VI**  
**NJOFTIMI PËR NDOTJEN E AJRIT**

Njoftimi për ndotjen e ajrit

Neni 16

16.1. Të gjithë operatorët, që shkarkojnë ndotës në ajër, detyrohen të publikojnë të dhënat për ndotjen e ajrit dhe të dërgojnë periodikisht njoftim të plotë në MMPH.

16.2. MMPH, në rast të gjendjeve të ndotjeve të tejskajshme dhe të smogut, njofton publikun e gjerë me të gjitha mjetet e komunikimit.

16.3. MMPH përgatit kadastrin e shkarkimeve në ajër në nivel vendi, regjioni, komune dhe për burimin individual të ndotjes. Një kopje e këtij kadastri i dërgohet Agjensionit të Statistikës.

16.4. Institucionet e ngarkuara për të njoftuar lidhur me ndotjen e ajrit i raportojnë periodikisht MMPH rezultatet e ndotjes. Rregullat, procedurat dhe afatet e raportimit përcaktohen me vendim të Qeverisë, me propozimin e MMPH.

**KREU VII**  
**PAJISJA ME LEJE MJEDISORE E VEPRIMTARIVE QË NDOTIN AJRIN**

Leja mjedisore për ndotësit e ajrit

Neni 17

Personat fizikë dhe juridikë vendas ose të huaj detyrohen të pajisen me leje mjedisore nga MMPH në bashkëpunim me pushtetin lokal për:

- a. ndërtimin dhe shfrytëzimin e burimeve të ndotjes, si dhe për ndryshimet e tyre të mëvonshme;
- b. projektimin e tipit standard dhe të projektmodelit për ndërtimin e burimeve të ndotjes;
- c. batimin e projekteve, ku përfshihen teknologji dhe prodhime të reja burimesh të ndotjes;
- d. ndryshimin e standardeve teknike dhe normave të shkarkimeve të gazta nga burime të ndryshme ndotjeje, kur zbatimi i tyre cenon mbrojtjen e ajrit;
- e. ndërtimin e burimeve të ndotjes, kur dokumentacioni i tij nuk miratohet, sipas një tipi standard ose projektmodeli;
- f. zëvendësimin e lëndëve djegëse dhe të lëndëve të para, që përdor burimi ndotës;
- g. prodhimin, importin dhe tregtimin e lëndëve djegëse, pajisjeve fikse, materialeve dhe produkteve, që ndotin ose mund të ndotin ajrin;
- h. ndryshimin e parametrave teknikë, operacionalë dhe të masave tekniko-organizative të burimit të ndotjes.
- i) ndryshimin e veprimtarisë, që dallon nga ajo bazë.



## Planifikimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja

### Neni 18

Planifikimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja bazohet në:

- a. Strategjinë për mbrojtje të ajrit nga ndotja ,
- b. Programin Kosovar të veprimit për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
- c. Programet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja,
- d. Raportet për zbatimin e planeve dhe programeve për mbrojtje të ajrit nga ndotja.

## Strategjia për mbrojtje të ajrit nga ndotja

### Neni 19

Strategjia për mbrojtjen e ajrit nga ndotja përcakton politikën e mbrojtjes së ajrit dhe menagjimin e cilësisë së ajrit të cilën e harton MMPH dhe miraton Kuvendi i Kosovës si pjesë të strategjisë për mbrojtje të mjedisit.

## Raportet për zbatimin e planeve dhe programeve

### Neni 20

20.1. Raporti për realizimin e planeve dhe programit të parashikuar me strategjinë për mbrojtjen e ajrit nga ndotja i prezentohet Kuvendit të Kosovës nga ana e Qeverisë së paku njëherë në vit.

20.2. Raportet përmbajnë të dhënat për cilësinë e ajrit, ndotësit, tendencat e zhvillimit të emisioneve të ndotësve të regjistruar në kadastër të emisioneve, matjet lidhur me përmirësimin e cilësisë së ajrit dhe rezultatet nga matjet.

## Programi Kosovar për mbrojtjen e ajrit nga ndotja

### Neni 21

Programi Kosovar për mbrojtjen e ajrit nga ndotja përcakton planet e veprimit për mbrojtjen e ajrit të cilën e harton MMPH dhe e miraton Kuvendi i Kosovës si pjesë e Programit të mbrojtjes së mjedisit.

## Programet lokale për mbrojtje të ajrit nga ndotja

### Neni 22

22.1. Programet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja definojnë politikën e mbrojtjes së ajrit nga ndotja dhe menaxhimin e cilësisë së ajrit përbrenda komunave në harmoni me Strategjinë kosovare të mbrojtjes së ajrit nga ndotja.

22.2. Programet lokale për mbrojtjen e ajrit nga ndotja do të jenë pjesë integrale e programeve lokale për mbrojtje të mjedisit. Raporti për zbatimin e programit shqyrtohet nga kuvendet e pushteteve lokale.

## KREU VIII MONITORIMI I CILËSISË SË AJRIT

### Neni 23

23.1. Monitorimi i cilësisë së ajrit zbatohet nga Ministria përmes Agjencionit të Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit /AKMM/ dhe institucioneve tjera kompetente, të cilat sigurojnë monitorimin e përherëshëm të cilësisë së ajrit si dhe ndikimin e tij në mjedis dhe shëndetin e popullatës.

23.2. MMPH me akt të veçantë cakton kriteret për përcaktimin e pikave monitoruese, numrin dhe shpeshësinë e matjeve, klasifikimin e ndotësve të cilat monitorohen, metodologjinë e punës, formën dhe kohën e raportimit të të dhënave.

23.3. Subjektet të cilat shkaktojnë ndotjen në ajër janë të obligueshme të organizojnë sistem të monitorimit intern me qëllim të përcjelljes së shkallës së ndotjes.

### Mbikqyrja inspektive

#### Neni 24

Gjatë mbikqyrjes inspektive në mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit me aplikim edhe të laboratorëve mobile, inspektori rregullisht mbikqyrë:

- a. Zbatimin e masave mbrojtëse të definuara në procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis,
- b. Punën e paisjeve të repartit dhe paisjeve mbrojtëse në burimet e regjistruara të ndotjes,
- c. Përbushjen e vlerave limit të emisionit dhe zbatimin e masave mbrojtëse,
- d. Zbatimin e matjes të emisionit dhe hartimin e raportit,
- e. Zbatimin e programeve sanuese dhe programeve për mbrojtjen dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit,
- f. Efikasitetin e masave për zvoglimin e ndotjes së ajrit.

## KREU IX FINANCIMI I MBROJTJES DHE PËRMIRËSIMIT TË CILËSISË SË AJRIT

### Financimi i mbrojtjes së ajrit nga ndotja

#### Neni 25

25.1. Fondet e nevojshme për përmirësimin dhe për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në Kosovë mund të sigurohen nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, nga të hyrat e qeverisë lokale, donacionet, apo nga kreditë në pajtim me rregullat e parapara me Ligjin për menagjimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

25.2. Fondet e siguruara sipas paragrafit 1 përdoren:

- a). për hartimin dhe zbatimin e programeve dhe masave për parandalimin apo uljen e nivelit të ndotjës së ajrit;
- b). për mbrojtjen e banorëve të Kosovës dhe mjedisit të saj, atëherë kur standardet minimale tejkalohen;
- c). për arritjen e obligimeve që i imponohen me akte ndërkombëtare për mjedis;
- d). për hulumtime shkencore apo të tjera të cilat janë të nevojshme për arritjen e qëllimit të këtij ligji;
- e). për aktivitete të tjera të nevojshme për zbatimin e këtij ligji.

Taksa për shkarkimet në ajër

Neni 26

Qeveria është përgjegjëse për caktimin e tatimeve që drejtpërsëdrejti lidhen me ndotjen reale apo të vlerësuar të ajrit, për ato nivele që janë të lejueshme për Kosovën.

## KREU X INSTRUMENTET EKONOMIKE

Neni 27

Me akte nënligjore, Qeveria mund të caktoj lehtësime dhe lirime nga pagesa e tatimeve, doganës dhe obligimeve tjera, për personat juridikë dhe fizikë, vendas dhe të huaj, për blerjen e pajisjeve për pastrimin e ajrit, për zhvillimin dhe përdorimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë (diell, erëra dhe bio gazëra) dhe për riciklimin e materieve ndotëse.

## KREU XI SANKSIONET NDAJ NDOTËSVE TË AJRIT

Sanksionet

Neni 28

28.1. Në kuptim të këtij ligji do të konsiderohen si kundërvajtje dhe do të ndëshkohen këto veprimtari:

- a. ushtrimi i veprimtarive në kundërshtim me nenin 17 të këtij ligji, pa leje mjedisore dhe dënohet me gjobë nga 1.000 Euro deri në 10.000 euro dhe pezullim të veprimtarisë deri në 3 muaj, kohë brenda së cilës subjekti duhet të pajiset me leje mjedisore;
- b. prodhimi, importimi ose tregtimi i lëndëve djegëse nga subjekte në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 paragrafi 5 të këtij ligji dhe dënohet me gjobë nga 1.000 euro deri në 5.500 euro, në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse të palejuara, si dhe bën sekuestrimin e lëndës djegëse në stoçe;

- c. përdorimi i lëndëve djegëse të ndaluara nga operatori, në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 paragrafi 6 dhe dënohet me gjobë nga 1.000 euro deri në 10.000 euro në varësi të sasisë dhe rrezikshmërisë që paraqesin lëndët djegëse, si dhe vendos pezullimin e veprimtarisë, për aq kohë sa të bëhet zëvendësimi i lëndës djegëse;
- d. prodhimi ose importimi nga ana e subjekteve i burimeve të lëvizshme të ndotjes, në kundërshtim me nenin 10 paragrafi 3 që nuk plotëson normat e shkarkimit, dënohet me gjobë nga 500 euro deri në 5.000 euro, në varësi të sasisë së prodhimit dhe importit, si dhe vendos mbylljen e përhershme të veprimtarisë;
- e. ndotja e ajrit nga operatori i burimit të ndotjes, duke shkelur normat e shkarkimit, normat në zona me mbrojtje të veçantë, rregullat në gjendje smogu a emergjence, kushtet teknike dhe kërkesat e përcaktuara në lejen mjedisore dhe dënohet me gjobë nga 1.000 euro deri në 10.000 euro, në varësi nga lloji dhe sasia e shkarkimeve ndotëse, si dhe ndërprerjen e veprimtarisë së burimit ndotës për aq kohë sa operatori të sjellë shkarkimet në normë të lejuar.

28.2. Me rastin e vënjes së gjobës sipas këtij neni, Inspektorati i MMPH-së do të marrë parasyshtë shkallën e dëmit të shkaktuar nga shkelja në fjalë.

28.3. Secili vendim i lëshuar nga Inspektorati i MMHP-së mund të apelohej pranë gjykatës përkatëse kompetente brenda 60 ditëve nga lëshimi i vendimit të inspektoratit.

## KREU XII DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

### Aktet nënligjore

#### Neni 29

29.1. Ngarkohet Qeveria e Kosovës që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 3, 4, 5, 6, 7, 10, 13, 14 dhe 16 të tij.

29.2. Ngarkohen Ministrinë përkatëse që, me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të nxjerrin aktet nënligjore për zbatimin e neneve 5, 7, 9, 12, 13, 15 dhe 16 të tij.

### Hyrja në fuqi

#### Neni 30

Ky Ligj hyn në fuqi pasi që të miratohet nga Kuvendi i Kosovës dhe në ditën e shpalljes nga Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

**Ligji Nr.2004/30**  
**28 korrik 2004**

**Kryetari i Kuvendit të Kosovës**

\_\_\_\_\_  
**akademik Nexhat Daci**